



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj):

1.1 Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020.

1.2 Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021.

1.3 Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-01.06.2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jastë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj):

1.1 Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020.

1.2 Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021.

1.3 Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-01.06.2020.

Naureda Llagami: Atëherë, po fillojmë mbledhjen plenare të datës 25 prill.

Siç jeni në dijeni nga rendi i ditës, nga ana e Këshillit kërkohet vendimmarrje për rreth 14 çështje.

Pa humbur kohë, unë do doja, nëse s'kemi diskutime mbi rendin e ditës, do doja që të fillonim me çështjen e parë, që ka të bëjë me miratimin e projektvendimeve në lidhje me fillimin e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, të cilët kanë plotësuar kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 182, nr. 183 dhe nr.185, datë 28.05.2020 ka vendosur hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (Gjykata e Apelit Tiranë në momentin e hapjes së procedurave) për 1 (një) pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile dhe 2 (dy) pozicione të lira në fushën e së drejtës penale. Gjithashtu, Këshilli me vendimin nr.129, datë

01.04.2021 ka vendosur hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (Gjykata e Apelit Durrës në momentin e hapjes së procedurave) për 1 (një) pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Pas përfundimit të afateve të aplikimit për të gjitha pozicionet e relatuar më lart, janë zhvilluar procedurat e verifikimit për plotësimin nga kandidatët aplikues të kriterëve të kandidimit, sipas vendimit nr.75, datë 23.05.2019 të KLGJ-së, lidhur me plotësimin e tre kriterëve të kandidimit, përkatësisht: “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Pas përfundimit të këtij verifikimi, për kandidaten {...}, me vendimin nr. 309, datë 10.09.2020, Këshilli ka vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale dhe një pozicion në fushën e të drejtës civile; për kandidaten {...}, me vendimin nr. 226, datë 02.06.2021 ka vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale dhe; për kandidatin {...}, me vendimin nr. 285, datë 08.09.2020 ka vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale.

Lidhur me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për ngritje në detyrë, në secilin prej vendimeve të shpalljes së pozicioneve të lira parashikohet se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave përkatëse, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional...”

Sa më sipër, bazuar në skemën e vlerësimit të gjyqtarëve pjesë e të cilit së fundmi janë edhe rregullat për vlerësimin e etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, miratuar me vendimin nr. 159, datë 05.04.2023 të KLGJ-së, i cili ka hyrë në fuqi në datën 13.04.2023 pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 63, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon mbledhjes plenare,

fillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e komandimit në Këshill për gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, të cilët kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, para hyrjes në fuqi të këtyre rregullave dhe veç gradimit për ta nuk ka një vlerësim tjetër të fundit në kohë, si dhe nuk rezulton të jenë përfshirë në program vlerësimi të miratuar nga Këshilli.

Lidhur me periudhën e vlerësimit, Komisioni vlerëson se në lidhje me gjyqtaren e komanduar znj. {...}, e cila ka kandiduar për ngritje në detyrë pas përfundimit të periudhës së komandimit në Këshill dhe para hyrjes në fuqi të vendimit nr. 159/2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjen zbatim neni 22 i këtij të fundit, në të cilin parashikohet se: “1. Këshilli llogarit periudhën e vlerësimit të individualizuar për çdo gjyqtar të komanduar duke filluar nga data 01.01.2019. [...] 4.Nëse gjyqtari që i ka mbaruar komandimi, ka kandiduar në procedura të lëvizjeve paralele ose ngritjes në detyrë, të shpallura para hyrjes në fuqi të këtyre rregullave dhe veç gradimit (vlerësim i parë) nuk ka vlerësim tjetër të fundit në kohë, të kryer apo që mund të kryhet sipas programeve të vlerësimit të miratuara nga Këshilli, vlerësimi fillon sipas një programi të veçantë, jo më vonë se dy javë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Në këtë rast periudha e vlerësimit llogaritet nga data e fillimit të komandimit por jo më parë se data 01.01.2019 dhe shtrihet deri në momentin e kandidimit. Periudha e vlerësimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit”.

Ndërsa në lidhje me dy gjyqtarët e tjerë të komanduar z. {...} dhe znj. {...}, të cilët kanë kandiduar për ngritje në detyrë gjatë komandimit në Këshill, por komandimi për ta nuk ka mbaruar në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit nr. 159/2023, gjen zbatim neni 23 i këtij të fundit, në të cilin parashikohet se: “2.Nëse gjyqtari që nuk e ka përfunduar komandimin në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, ka kandiduar në procedura të lëvizjeve paralele ose ngritjes në detyrë, të shpallura para hyrjes në fuqi të këtyre rregullave dhe veç gradimit (vlerësim i parë) nuk ka vlerësim tjetër të fundit në kohë, të kryer apo që mund të kryhet sipas programeve të vlerësimit të miratuara nga Këshilli, vlerësimi fillon sipas një programi të veçantë, jo më vonë se dy javë nga hyrja

në fuqi e këtij vendimi. Në këtë rast periudha e vlerësimit llogaritet nga data e fillimit të komandimit, por jo më parë se data 01.01.2019 dhe shtrihet deri në momentin e kandidimit. Periudha e vlerësimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit”.

Komisioni ka vlerësuar që procedurat e vlerësimit për të tre gjyqtarët e mësipërm duhet të fillojnë me tre akte administrative individuale të veçanta, pra jo nëpërmjet një akti kolektiv, për shkak se periudha e tyre e vlerësimit, sipas rregullave të mësipërme është e ndryshme. Ajo fillon për secilin gjyqtar të komanduar në datën 01.01.2019 dhe përfundon në mënyrë të individualizuar, e ndërvarur nga momenti kur znj. {...} ka ndërprerë komandimin, dhe z. {...} dhe znj. {...} kanë kandiduar për ngritje në detyrë. Konkretisht:

-Për gjyqtaren {...} periudha e vlerësimit do të shtrihet nga data 01.01.2019 deri në datën 07.02.2020, datë në të cilën gjyqtarja me vendimin nr. 69, datë 07.02.2020 është komanduar përkohësisht në detyrën e inspektores në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

-Për gjyqtaren {...} periudha e vlerësimit do të shtrihet nga data 01.01.2019 deri në datën 15.04.2021, datë në të cilën gjyqtarja ka kandiduar për ngritje në detyrë.

-Për gjyqtarin {...} periudha e vlerësimit do të shtrihet nga data 01.01.2019 deri në datën 01.06.2020, datë në të cilën gjyqtari ka kandiduar për ngritje në detyrë.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhat si më sipër do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin (për aq sa ato janë të zbatueshme) dhe nenin 8 të vendimit nr. 159, datë 05.04.2023 “Rregullat për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”. Këto vlerësime do të zhvillohen bazuar në rregullat e përcaktuara në nenin 71 të Ligjit për Statusin si dhe rregullat e mëtejshme që plotësojnë skemën e vendimin për gjyqtarët e komanduar bashkë me Metodologjinë e Pikëzimit të tyre.

Për sa më lart, bazuar edhe në nenet e sipërcituara si dhe ato të përmendura në pjesën hyrëse të çdo projekt-akti, nga ana e Komisionit janë përgatitur 3 (tre) projektvendime:

Projektvendim për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës znj. {...}.

Në pikën e parë të të cilit parashikohet pikërisht kjo dhe përcaktohet edhe periudha e vlerësimit që është data 01.01.2019 - 07.02.2020, gjyqtare e cila gjatë kësaj periudhe ka ushtruar detyrën e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve por ka punuar pranë Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi i dytë bën fjalë për fillimin e procedurës së vlerësimit për gjyqtaren znj. {...}, për periudhën 01.01.2019 - 15.04.2021. Edhe për këtë gjyqtare vlejnjë të njëjtat parashikime si më sipër. I vetmi ndryshim është periudha e vlerësimit.

Projektvendimi i tretë për gjyqtarin e komanduar z. {...}. Përmbajtja e projektvendimit është e njëjtë me dy të parët, por ndryshon vetëm periudha e vlerësimit që është 01.01.2019 - 01.06.2020.

Në pikën e dytë të tre projektvendimeve përcaktohet caktimi i relatorit nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Në procedurën e shortit Komisioni ka vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët e këtij Komisioni, duke siguruar një shpërndarje të barabartë pune mes tyre (një vlerësim secili anëtar). Lidhur me rregullat e realizimit të shortit, shorti është sipas praktikës që kemi: në një enë do të vendosen tre shirita letre me emrin e secilit gjyqtar për të cilin fillon procedura, ndërsa në një enë tjetër tre shirita letre me emrat e secilit anëtar të Komisionit. Procedura e shortit fillon me përzgjedhjen fillimisht të gjyqtarit të komanduar.

Së fundi është parashikuar edhe hyrja në fuqi e secilit akt administrativ menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në hedhjen e shortit i cili do hidhet nga administrata.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e parë shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve të komanduar: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Futen në enën tjetër shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Brikena Ukperaj, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes:

Gjyqtari i parë i përzgjedhur është zonja {...}. Relatore për zonjën {...} përzgjidhet zonja Yllka Rupa.

Gjyqtari i dytë i përzgjedhur është zonja {...}. Relatore për zonjën {...} përzgjidhet zonja Brikena Ukperaj.

Gjyqtari i tretë i përzgjedhur është zoti {...}. Relatore për zotin {...} mbetet zonja Irena Plaku.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim projekt-aktin e parë që ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës znj. {...}.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 07.02.2020, për gjyqtaren e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj. {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve (Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Këshillit të Lartë Gjyqësor).

2. Caktimin e znj. Brikena Ukperaj si relatore për vlerësimin e gjyqtarës së komanduar, znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Hedhim në votim aktin e dytë për fillimin e procedurës së vlerësimit për gjyqtaren e komanduar zonjën {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 15.04.2021, për gjyqtaren e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj. {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në

Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve (Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Këshillit të Lartë Gjyqësor).

2. Caktimin e znj. Yllka Rupa si relatores për vlerësimin e gjyqtarës së komanduar, znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Hedhim në votim aktin e tretë që ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin e komanduar zotin {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord. (*Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, e vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: “Kam votuar “dakord” për të gjitha pikat”. E-maili me konfirmimin e votës së saj i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 01.06.2020, për gjyqtarin e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, z. {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në

Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve (Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Këshillit të Lartë Gjyqësor).

2. Caktimin e znj. Irena Plaku si relatore për vlerësimin e gjyqtarit të komanduar, z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë. Për më shumë detaje, fjalën z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë më herët, me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë në fushën e së drejtës penale.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet të cilat provojnë plotësimin nga ana e kandidatëve të tre kritereve formale të parashikuara përkatësisht nga nenet 8/3, 47/4, 48/8 të ligjit “Për statusin”.

Në këtë kuadër, nga analiza e këtij dokumentacioni ka rezultuar që, në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008, ndërkohë që me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5476, datë 05.10.2007, “Për caktimin e përkohshëm të kandidatëve për magjistratë, për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë”, ajo është emëruar si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 5 tetor 2007 deri në 25 mars 2009, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6107, datë 25.03.2009, “Për emërim gjyqtari”, ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Pranë kësaj gjykate, kandidatja ka gjykuar çështje civile, administrative dhe çështje penale të të gjitha kategorive Në vijim me vendim nr. 109 datë 23.7.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë znj. {...} është deleguar përkohësisht për të kryer funksionin e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj.

{...} ka filluar detyrën me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.{...}, datë 05.10.2007, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 25.03.2009, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje ku vijon të ushtrijë funksionin dhe aktualisht. Së fundi me vendim nr. {...} datë 23.7.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë znj. {...} është deleguar përkohësisht për të kryer funksionin e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Me vendim nr. 293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet zgjedhja si anëtare e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, me një mandat 4 vjeçar. Me vendim nr. 97, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për një periudhë njëvjeçare. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 15 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Sipas informacionit elektronik dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që kandidatja të ketë gjykuar gjithsej 53 çështje civile me natyrë të përgjithshme, 11 kërkesa civil, 2 kërkesa penale dhe 4 çështje penale.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, rezulton që kandidatja referuar dhe urdhrit nr. {...} datë 10.01.2011; nr. {...} datë 04.01.2013 dhe vendimit nr.{...} prot., datë 25.06.2019 të kryetarit të gjykatës është vendosur që të gjykojë çështje civile /tregtare si dhe penale.

Edhe nga analiza e këtyre akteve, rezulton që ajo të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale.

Gjithashtu u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” apo i “papajtueshmërisë ambientale”, nga të cilat rezultoi që nuk kishin shkaqe për të penguar atë më tej në kandidimin e saj.

Kështu që, përfundimisht, nga ana e KZHK-së ju propozohet projektvendimi i cili ju sugjeron të miratoni me këtë dispozitiv:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Nëse, s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord. (*Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, e vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: “Kam votuar “dakord” për të gjitha pikat”. E-maili me konfirmimin e votës së saj i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. BIRN.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti i dytë që ka të bëjë edhe kjo për verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidimit për znj. {...}. Sërish fjalën e ka zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Me vendimin nr. 502, 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në fushën e së drejtës penale. Një nga kandidatet ka qenë edhe zonja {...}. Në kuadër të përcaktimit tim si relator për verifikimin e plotësimit të kriterëve të ngritjes në detyrë është administruar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm i cili provon plotësimin prej saj të kriterëve formale të kandidimit. Kriteret e parashikuara nga neni 8/3, 47/4 dhe 48/8, përkatësisht që kanë lidhje me “papajtueshmërinë ambientale”, “përvojën minimale dhe maksimale” dhe “mospasjen e masave disiplinore”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë dhe si gjyqtare e komanduar.

Gjithashtu, po nga këto të dhëna rezulton që kandidatja {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

Gjithashtu nuk provohet të ketë masë disiplinore, nga aktet e administruara nga Departamenti ose Drejtoria e Personelit; si dhe nuk verifikohen kriteret të papajtueshmërisë ambientale, të cilat mund të përbënin shkak për pengimin e saj për kandidimin e mëtejshëm.

Në këtë kuadër KZHK-ja propozon draftin bashkëlidhur, ku në dispozitiv do të gjeni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit lidhur me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile. Për më shumë detaje fjalën e ka zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Sipas vendimeve të shpallura të Këshillit të Lartë Gjyqësor për hapjen e 14 procedurave të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, për vendimet nr. 11 deri nr.20, datë 18.01.2023 dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. Pas përfundimit, ka kandiduar edhe kandidatja znj. {...} (referuar më poshtë si kandidatja), gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Pasi janë bërë procedurat, nga ana e Këshillit është caktuar relatori dhe është shfaqur mendimi nga ana e kandidatës që nuk ka asnjë shkak apo pretendim në lidhje me relatorin apo me ndonjë anëtar të Këshillit, është vijuar me verifikimin e rezultateve mbi kriteret e kandidimit të kësaj kandidate dhe ka rezultuar që për kandidaten është verifikuar kriteri i përvojës profesionale specifike minimale, ku sipas ligjit *magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë.*

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier më datë 23.01.2014 dhe vazhdon të ushtrojë detyrën në po këtë gjykatë. Në periudhën janar/2015 deri në mars/2016 ka qenë pjesë e seksionit penal, ku gjatë kësaj periudhe ka vijuar të gjykojë edhe çështje civile të mbartura. Në vijim ka qenë pjesë e seksionit penal, por gjithsesi ka vijuar të gjykojë edhe çështjet civile të mbartura. Nga vitit 2021-2022, gjyqtarja thekson se ka gjykuar çështje penale dhe civile së bashku (për shkak të numrit të reduktuar të trupës gjyqësore, gjykata ka qenë në pamundësi të operojë me seksione).

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, rezulton se kandidatja ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Me dekret nr. {...}/2011 të Presidentit të Republikës caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 8460, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Pra, vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 11 vite. Zonja Lice nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidatja prej periudhës 22.07.2021 deri në datë 13.09.2022 ka gjykuar çështje gjyqësore të seksionit penal dhe civil.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit nr. 15, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Është verifikuar mospasja masë disiplinore dhe ka rezultuar, përveç vetëdeklarimit, rezulton edhe nga informacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore që zonja Lice nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Për kandidaten zonjën {...} u verifikua edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale. Është përcaktuar se çfarë përfaqëson papajtueshmëria ambientale ku përcaktohet që “Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficaenca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.

Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”. Si dhe sipas parashikimeve të pikës 3, thuhet që: “Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

E lexova që herët e tjera, për rastet e tjera që do kalojmë, mos ta parashtrojmë tekstualisht.

Pra është kryer edhe ky verifikim dhe gjatë verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, relatori ia ka propozuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe në mbledhjen e datës 06.04.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ka marrë në shqyrtim dhe ka vendosur kualifikimin e kandidates, duke u shprehur për:

Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave

të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime...

Po!

Brikena Ukperaj: Atëherë, unë kam një diskutim lidhur me mënyrën sesi do të bëjmë interpretimin e nenit 43, pika 6 e ligjit. Ky është vendimi i parë që Këshilli merr për kualifikimin e kandidatëve në lëvizje paralele. Nuk kemi bërë asnjëherë lëvizje paralele.

Nga relacioni rezulton që është verifikuar përvoja e përgjithshme profesionale e gjyqtarës, janë verifikuar të gjitha kriteret e ligjit. Unë në fakt kam të paqartë nëse nga ana e Komisionit (kjo është një pyetje që ju bëj) e keni konsideruar edhe përvojën profesionale të gjyqtarës? Pra ideja është, si do të interpretohet neni 43, pika 6 që thotë magistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale? A është e nevojshme pesë vjetëshi si përvojë e përgjithshme profesionale apo jo? Është interpretim që duhet ta bëjmë në këtë moment, pavarësisht se për zonjën Lice nuk shtrohet diskutimi në fakt sepse ka një përvojë profesionale të gjatë. Por mund të na ndodhë që të kemi kandidatë të tjerë në vijueshmëri të procedurave të lëvizjeve paralele. Dhe që të mos kemi paqartësi lidhur me interpretimin, mendoj që duhet ta ndajmë këtë gjë sot. Është vendimi i parë dhe pastaj ta kemi më të thjeshtë në vijim.

Dritan Hallunaj: Atëherë, procedura që ne kemi ndjekur është e tillë: Duke parë nëse kriteret e përgjithshme, që ajo i plotëson, pra qenia në funksion 11 vite, si magjistrate, ndërsa për sa i përket përvojës specifike profesionale në 5 vitet e fundit është kuptuar që: marrim një informacion nga gjykatat nëse brenda kësaj periudhe ka... (e ndërpret mendimin). Dhe këtu ka ardhur informacioni dhe është specifikuar edhe në relacion që kandidatja prej periudhës 22.07.2021 deri në periudhën 13.09.2022 ka gjykuar çështje gjyqësore të seksionit penal dhe civil. Pra brenda kësaj periudhe ka pasur edhe penale dhe civile, por që në rastin konkret kjo kandidate është për një pozicion që i përfshin të dyja, pra për fushën e së drejtës civile. Pra brenda periudhës 1-vjeçare ka gjykuar në të dyja këto kategori (civile dhe penale). Kështu që ne e kemi marrë si kualifikim të saj, pasi ka përvojën, plotëson edhe këto kriteret.

Brikena Ukperaj: Edhe unë dakord jam me kualifikimin. Nuk kam asnjë gjë. Mendoj që Këshilli duhet të ketë një qëndrim nëse veç periudhës specifike që ka një vit në pesë vitet e fundit, a është e nevojshme pasja e pesë viteve eksperiencë pune për gjyqtarët që... Duhet ta ndajmë sot dhe pastaj mos e ndajmë në rastet kur mund të ketë diskutim. Më kupton? Kjo është e gjitha.

Alban Toro: Ne e kemi ndarë bashkërisht. Që do të thotë, mirë do të ishte që të ishte edhe kolegu që mungon, të ishte prezent.

Brikena Ukperaj: Do votojmë sot për këtë gjë Alban.

Alban Toro: Ok! Unë po jap një sugjerim. E mira është që në çdo vendimmarrje që ne kemi bërë, ne kemi tentuar gjithmonë që të kemi një votë pothuajse të përgjithshme, jo dakordësie, por të paktën secilit t'i jepet mundësia të diskutojë. Sepse aktualisht ne po interpretojmë një ligj, apo jo? KZHK-ja ka interpretuar që, të paktën, në opinionin tim, atë që unë ndaj në interpretimin tim, minimalisht duhet të jenë 5 vjet, ku

në këto 5 vjet, 1 vit duhet ta kesh patjetër në fushën specifike, dhe këtë ka tentuar ligji në shumë kufizime që ka vendosur si për ngritjet në detyrë në apel ku ka kërkuar 7 vjet apo në Gjykatë të Lartë kur ka thënë që të jesh anëtar i Gjykatës së Lartë duhet që të kesh qenë të paktën 4 vjet në shkallën e parë, përveç përvojës së përgjithshme që kërkohet për Gjykatën e Lartë. Pra ka përfshirë, të themi, kritere limituese për të cilat nëse nuk plotësohen, detyrimisht pastaj kërkon skualifikimin.

Brikena Ukperaj: Qëndrimi si Komision ka qenë i tillë, që përveç 1 vit përvojë profesionale, duhet të ketë patjetër 5 vite (e interpretoni ju), nga të cilat 1 vit në këto 5 vitet e fundit. Se 5 vitet mund t'i ketë pasur edhe para 10 viteve.

Alban Toro: Saktë. Në këto 5 vitet e fundit.

Brikena Ukperaj: Domethënë në 5 vitet e fundit të ketë 1. Por duhet të ketë edhe 5 vjet përvojë profesionale.

Alban Toro: Po patjetër!

Brikena Ukperaj: Atëherë, ky është qëndrimi që keni mbajtur si Komision.

Alban Toro: Ky është qëndrimi që kam mbajtur unë, besoj që edhe Komisioni. Por secili duhet të flasë në aspektin e vet.

Brikena Ukperaj: Unë e ngrita si diskutim për arsye se më mirë ta bëjmë sot sesa ta bëjmë kur kemi kandidatë që na vihet në diskutim gjëja.

Si do votojmë sot?

Marçela Shehu: Në të dyja variantet.

Kandidatët sot i plotësojnë kushtet?

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Brikena Ukperaj: Sepse na ka ndodhur që në raste të tjera thoni që e kemi pas shkruar në relacion dhe ka mbajtur qëndrim Këshilli. Se në relacion është shkruar që ka përvojë të përgjithshme 11 vjet, dhe prandaj unë isha e paqartë.

Cili është roli i përvojës së përgjithshme profesionale në këtë rast? A është kusht që duhet ta ketë patjetër mbi 5 vjet? Sepse varet nga ecuria e vendimmarrjeve të tjera që do kemi.

Marçela Shehu: Atëherë unë propozoj që ky diskutim të bëhet në momentin kur të vihet vërtetë në diskutim ky standard. Pra nëse ka kandidatë, për shembull, që kanë tre vjet përvojë profesionale dhe do të vlerësohet nga Komisioni që nuk kualifikohet, atëherë le të bëhet diskutimi në Këshill, duke mbështetur edhe qëndrimin e zotit Toro që të jetë e gjithë përbërja e Këshillit, edhe kryetari i Komisionit të Karrierës mendoj që duhet të jetë prezent, që edhe Komisioni të dali pastaj me një mendim të unifikuar.

Kur të vijë momenti. Atë po them. Kur të vijë momenti. Nuk ka lidhje me emrin. Se parimi është parim.

(Zonja Plaku flet pa ndezur mikrofonin.)

Marçela Shehu: Dakord pra. Unë po them që kur të vijë rasti, të bëhet diskutimi. Nuk ka lidhje me emrin. Ka lidhje me parimin.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Atëherë, lidhur me këtë diskutimin, a jemi dakord që ta

diskutojmë nëse kemi një rast konkret dhe për ta vlerësuar në rastin konkret? Jemi dakord?

Alban Toro: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin sipas propozimit që ka sjellë relatori, për ta vijuar diskutimin në rastin konkret, rast pas rasti.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord, me argumentim që gjyqtarja në rastin konkret ka një vit përvojë profesionale në 5 vitet e fundit, por këto të fundit nuk janë kusht për kualifikimin e saj në procedurat e lëvizjes paralele.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12 dhe nr. 20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12 dhe nr. 20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë edhe ky me kualifikimin e kandidatës zonjës {...} për vijimin e procedurave të lëvizjes paralele. Sërish është relator z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Me vendimin nr. 11 dhe nr. 24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr.20 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe zonja {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Është caktuar relatori dhe me caktimin e relatorit janë kryer të gjitha verifikimet procedurale apo komunikimet procedurale që kanë të bëjnë me njoftimin për fillimin e procedurës, caktimin e relatorit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, etj., për të cilat kandidatja nuk ka parashtruar ndonjë pretendim në lidhje me sa u diskutua.

Është vijuar me rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit, që kanë të bëjnë me kriterin e pasjes së përvojës profesionale specifike minimale. Sipas ligjit janë bërë verifikimet përkatëse si dhe sipas dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se znj. {...} ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Me dekret nr. {...}/2011 të Presidentit të Republikës caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. {...}, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Në mars të vitit 2022 është zgjedhur Zëvendëskryetare e kësaj gjykate, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht. Pra rezulton që ka vjetërsi në funksion 11 vite. Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidatja prej periudhës janar 2014 e në vijim ka gjykuar të gjitha llojet e

çështjeve civile dhe penale, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat nuk ka pasur ndarje në dhoma dhe seksione (kjo sipas urdhrit të gjykatës).

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të shpallur me vendimin nr. 12 dhe nr. 20, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Gjithashtu është verifikuar edhe kriteri i mospasjes masë disiplinore në fuqi. Duke përfshirë këtu edhe formularin e vetëdeklarimit por edhe nga aktet e përcjella nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton që kandidatja nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Për kandidaten znj. {...} është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. E përcaktova që në relatimin e parë se çfarë përfaqëson papajtueshmëria ambientale. Gjatë verifikimit të dokumentacionit të administruar nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke vlerësuar procedurën e verifikimit të plotë për kandidaten znj. {...}, relatori ia ka parashtruar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 06.04.2023, ka vendosur kalimin për shqyrtim të çështjes në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku përfundimisht të vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12 dhe nr. 20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit nëse nuk kemi diskutime.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro, me të njëjtin arsyetim si tek projekt-akti paraardhës.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12 dhe nr. 20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.11 dhe nr. 12, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.11 dhe nr. 12, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatit z. {...}. Për këtë sërish zoti Hallunaj relator.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Ashtu siç relatuam edhe më parë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimmarrjen e saj ka vendosur hapjen e 14 procedurave të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to me vendimet nr. 11 deri në nr.20, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe zoti {...} gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Janë kryer të gjitha procedurat. Është caktuar relatori i çështjes dhe është njoftuar kandidati nëse ka papajtueshmëri apo ka pretendime në lidhje me relatorin. Kandidati nuk ka parashtruar ndonjë pretendim në lidhje me relatorin apo procedurën e kryer ndaj tij.

Janë verifikuar pra kriteret e kandidimit dhe konkretisht po parashtrroj rezultatet e verifikimit të kriterit të përvojës profesionale specifike minimale. Siç relatuam, ligji për statusin përcakton se magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, me vendim nr. {...}, datë 24.11.1993 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtar efektive pranë Gjykatës së Rrethit Burrel. Me vendim nr. {...}, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet edhe Zëvendëskryetar në Gjykatën e Rrethit Mat. Me vendim nr. {...}, datë 22.04.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 11.10.2013. Me vendim nr. {...}, datë 11.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, funksion të cilin

ushtron edhe aktualisht. Me vendim nr. 5, datë 24.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pezullohet nga detyra për një periudhë 1-vjeçare për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe me vendim nr. {...}, datë 16.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konfirmohet në detyrë. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 29 vite dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidati prej periudhës prill 1995 e në vijim ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile dhe penale, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat nuk ka pasur ndarje në dhoma dhe seksione.

Për kandidatin z. {...} është verifikuar kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Përveç depozitimit të formularit ku deklaroi që nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Pasi përcaktuam në rastet e mëparshme se çfarë përfaqëson kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, i cili është pasqyruar edhe në relacion, por për efekt kohe nuk e citojmë, ka rezultuar që gjatë verifikimit nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati. Prandaj nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet që të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke e vlerësuar procedurën e plotë për verifikimin e kandidatit z. {...}, relatori ia parashtrroi atë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës më datë 06.04.2023 vendosi që ta kalojë për shqyrtim çështjen në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar për:

1.Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr. 12, datë 18.01.2023.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, nëse nuk kemi diskutime kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1.Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr. 12, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)

5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e

procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve për kandidimin për ngritjen në detyrë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Relacion për sa i përket gjendjes së faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kriterëve të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të kandidatit z. {...}.

Me vendimin nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (Durrës dhe Korçë) në fushën e të drejtës penale. Pra janë të tre vendimet në të njëjtën fushë.

Në këtë procedurë ka kandiduar dhe zoti {...}.

Pastaj kanë filluar procedurat e Këshillit në lidhje me caktimin e relatorit si dhe njoftimet që i janë kryer kandidatit në lidhje me fillimin e procedurës për verifikimin e kushteve dhe kriterëve, për caktimin e relatorit dhe për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi pretendim në lidhje me relatorin e caktuar apo procedurën e ndjekur deri në ato momente.

Brenda afateve të përcaktuara, kandidati ka paraqitur deklaratën e pasurisë dhe sipas pikës 9, të vendimit nr. 502, 503, 504, datë 21.11.2022, është përcaktuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, menjëherë fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”. Gjithashtu përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë

përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale.”.

Në vijim, në verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me komunikimin elektronik ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin përkatës në lidhje me kandidatin të administruar për kandidatin, siç do të shpjegohet edhe më poshtë.

Rezultatet e verifikimit për kandidatin për tre kriteret e verifikimit.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i pasjes së “përvojës profesionale minimale”. Siç thamë, në ligj përcaktohet që: Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet që ai ka ushtruar funksionin në disa gjykata, si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë (shkurt 1996 – maj 1998), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (qershor 1998 – nëntor 2000/ ku ka ushtruar edhe funksionin e kryetarit të kësaj gjykate), Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (janar 2004 – dhjetor 2019), Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (dhjetor 2019 – mars 2020) dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (mars 2020 e në vijim).

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, për kandidatin z. {...} konstatohet që: ka filluar detyrën me vendim nr. {...}/1996 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku emërohet

gjqtar në Gjykatën e Rrethit Delvinë. Me Dekret nr. {...}, datë 29.05.1998 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Sarandë. Me urdhër nr. {...}, datë 29.06.1999 komandohet për të ushtruar funksionin e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me dekret nr. {...}, datë 27.11.2000 të Presidentit të Republikës emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.12.2003 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Me vendim nr. 300, datë 18.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Me vendim nr. 130, datë 30.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet mbarimi i caktimit të përkohshëm, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pra në total, vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 27 vite.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike, në kërkesën për shprehje interesi, kandidati ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për një periudhë më shumë se 15 vjet.

Sa më sipër, duke pasur parasysh një përvojë të tillë, u vlerësua të mos kërkohej informacion nga gjykatat e tjera respektive ku ai ka ushtruar detyrën, lidhur me përvojën profesionale në fushën e së drejtës penale, pasi vërtetohet eksperiencia e nevojshme në fushën e së drejtës penale.

Për kandidatin u verifikua edhe “mospasja masë disiplinore në fuqi” dhe rezulton që ky kandidat, sipas dokumentacionit dhe formularit të deklarimit por edhe

dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” dhe ka rezultuar që për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit, nga ana e relatorit i është dërguar materiali Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision, më datë 05.04.2023 ka vendosur:

- Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

- Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, nëse s’kemi diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: (Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohej në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, e vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: “Kam votuar “dakord” për të gjitha pikat”. E-maili me konfirmimin e votës së saj i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit lidhur me verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)

5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e

procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti i radhës që ka të bëjë me verifikimin e kriterëve për kandidatin z. {...}. Sërish zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Për zotën {...} i cili ka kandiduar për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022, në fushën e së drejtës penale, është caktuar relatori. Nuk ka shfaqur ndonjë kundërshti në lidhje me të. Nga ana jonë është vjuar me rezultatin e verifikimit për tre kriteret e kandidimit dhe rezulton që është verifikuar kriteri i pasjes së “përvojës profesionale minimale”, sipas dokumentacionit rezulton që për kandidatin z. {...} konstatohet që: me vendim nr. {...}, datë 01.10.2001 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë propozohet për t’u emëruar provizorisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Me vendim e datës 21.10.2002 i propozohet Presidentit të Republikës për t’u emëruar provizorisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe më vonë është emëruar si kryetar i kësaj gjykate në vitin 2008, funksion të cilin e ka ushtruar deri në vitin 2013. Me vendim nr. 372/2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Më vonë është transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2016, ku dhe aktualisht ushtron funksionin si gjyqtar. Pra nga të dhënat rezulton që vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 21 vite.

Në lidhje me pasjen e kriterit mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale, është marrë informacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe sipas statistikave rezulton që nga viti 2002 deri në vitin 2016, kandidati zoti {...} ka gjykuar në vazhdimësi çështje civile/penale për të gjithë periudhën (pra për 14 vjet ka gjykuar në të dy kategoritë: edhe civile edhe penale). Plotësohet pra edhe kriteri i pasjes së përvojës profesionale në fushën e së drejtës penale.

Është verifikuar edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” ku rezulton që kandidati nuk ka një masë të tillë.

Gjithashtu, për sa i përket kriterit të “papajtueshmërisë ambientale” është verifikuar dhe ka rezultuar nga dokumentacioni që zoti {...} nuk ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në këto kushte, duke e vlerësuar procedurën e plotë, relatori ia ka parashtruar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision, më datë 05.04.2023 ka vendosur ta kalojë në seancë plenare Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për:

- Verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e shpallura me nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të pasjes “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

- Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për vendimet nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit nëse s’kemi diskutime.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: (Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohej në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, e vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: “Kam votuar “dakord” për të gjitha pikat”. E-maili me konfirmimin e votës së saj i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm [...].

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. BIRN.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Për më shumë detaje, prapë fjalën ia jap zotit Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është hapur procedura për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e së drejtës penale.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Janë vijuar procedurat për njoftimin e kandidatit, relatorit apo edhe anëtarëve të tjerë dhe nuk ka shfaqur ndonjë pretendim.

Më tej është vijuar me rezultatet e verifikimit paraprak që kanë të bëjnë me pasjen e “përvojës profesionale minimale”, dhe meqenëse është një rast që edhe u përsërit dhe të gjitha janë në materialin e parashtruar, ka rezultuar që vjetërsia në ushtrimin e funksionit të këtij magjistrati është 29 vite.

Gjithashtu ai rezulton që të ketë edhe 7 vite përvojë të përgjithshme profesionale.

Ndërsa për efekt të përvojës specifike profesionale, kandidati ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat rezulton që brenda kësaj periudhe, në vazhdimësi, për një periudhë prej 29 vitesh, gjyqtari ka gjykuar çështje civile/penale, duke qenë se gjykata nuk ka qenë e ndarë në dhoma apo seksione.

Në këto kushte plotësohet edhe kriteri tjetër i pasjes mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale.

Për kandidatin zotin {...} është verifikuar “mospasja e masës disiplinore në fuqi”. Përveç formularit të vetëdeklarimit dhe nga informacioni i përcjellë nga Departamenti i

Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton që kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Gjithashtu u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në këto kushte, duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij, relatori i ka parashtruar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës materialet dhe në mbledhjen e këtij Komisioni datë 05.04.2023, ky Komision vendosi të kalojë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar për:

- Verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

- Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12, nr.17 dhe nr.20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12, nr.17 dhe nr.20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatës {...}. Fjalën e ka zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në kuadër të përpjekjeve që po bën Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e vendeve vakante në të gjithë sistemin gjyqësor, në mënyrë të veçantë në Tiranë, me vendimet 11-20, datë 18.01.2023 kanë filluar procedurat e lëvizjes paralele për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile. Një nga kandidatet ka qenë edhe zonja {...}, për të cilën, me cilësinë e relatorit kam administruar aktet e nevojshme të cilat do të provojnë plotësimin e kriterëve formale në këtë kandidim.

Fillimisht më duhet të theksoj që zonja {...} ka vjetërsi në ushtrimin e funksionit të magjistratit rreth 8 vite.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidatja prej periudhës qershor 2016 e në vijim ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile, administrative, familjare, tregtare dhe penale, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër nuk ka pasur ndarje në dhoma dhe seksione.

Në këtë kuadër rezulton që deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Gjithashtu nuk rezulton që të ketë masë disiplinore në fuqi apo të ekzistojë ndonjë shkak në kuadër të kriterit të papajtueshmërisë ambientale e cila do ta pengonte në vijueshmërinë e kandidimit të saj.

Në këto rrethana, në përputhje me procedurën që administron Këshilli, ju është propozuar nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës drafti, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni si më poshtë:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të

shpallur me vendimin nr. 12, nr.17 dhe nr.20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.16 dhe nr.18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.16 dhe nr.18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatit {...}. Sërish fjalën e ka zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Edhe kandidati {...} është një nga kandidatët të cilët ka konkurruar në kuadër të kryerjes së procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për pozicionet e hapura me vendimet nr. 11-20, 18.01.2023

Edhe për këtë kandidat janë administruar aktet e nevojshme të cilat do të konfirmojnë plotësimin e kriterëve formale për këtë kandidim.

Nga këto akte ka rezultuar që ky kandidat zotëron një vjetërsi në ushtrimin e funksionit të magjistratit rreth 11 vite.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidati prej periudhës janar 2014 - mars 2023 ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile, administrative, familjare, tregtare dhe penale, pasi kjo gjykatë nuk ka pasur ndarje në dhoma dhe seksione.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar deri në momentin e kandidimit, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Edhe për këtë kandidat nuk ka kriteret të tilla të cilat në kuadër të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” apo të “papajtueshmërisë ambientale” do të pengonin kandidimin e tij të mëtejshëm, kështu që nga ana e Komisionit ju është propozuar drafti përkatës në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni si më poshtë:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.16 dhe nr. 18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatës {...}. Sërisht relator është zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Edhe zonja {...} bën pjesë tek kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozicionet e hapura me vendimet nr. 11-20, 18.01.2023 që i përkasin procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me cilësinë e relatorit edhe për këtë kandidate kam administruar aktet e nevojshme të cilat të provojnë plotësimin e kriterëve formale të nevojshme për vijueshmërinë e kandidimit.

Nga këto akte ka rezultuar që kandidatja në fjalë ka vjetërsi në ushtrimin e funksionit të magjistratit rreth 10 vite.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidatja për periudhën 2014 - qershor 2022 ka gjykuar në total 3336 çështje, nga të cilat 1003 çështje civile dhe 852 kërkesa civile.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton se: “Gjyqtarja {...} për periudhën 20.06.2022-27.01.2023 ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile dhe penale pasi Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka pasur ndarje në dhoma dhe seksione për shkak të limitimit të magjistratëve në të.

Përfundimisht rezulton që ajo të ketë mbi 1 vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Edhe për këtë kandidate u verifikua mundësia e pasjes së ndonjë mase disiplinore apo papajtueshmëri ambientale. Nga ky verifikim rezultoi që nuk ekzistojnë shkaqe të tilla të cilat do të pengonin kandidimin e saj për më tej.

Përfundimisht, nga ana e KZHK-së ju është propozuar drafti përkatës, në dispozitivin e të cilit do ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

74



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.18, nr.19 dhe nr.20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.18, nr.19 dhe nr.20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që është kualifikimi i kandidatit {...}, edhe ky në lidhje me lëvizjen paralele. Sërish relator është zoti Toro.

Alban Toro: Edhe kandidati z. {...} bën pjesë tek konkurrimet e shumta të magjistratëve të bëra për vendimet nr. 11-20, 18.01.2023, me atë të të cilave Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në kuadër të administrimit të akteve të cilat do të provojnë plotësimin e kriterëve të parashikuara nga ligji për të, nga ana e relatorit janë administruar dhe analizuar këto akte, nga të cilat rezulton që ky magjistrat ka një vjetërsi në ushtrimin e funksionit të magjistratit rreth 8 vite.

Në lidhje me përvojën profesionale specifike në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, nga verifikimet e kryera lidhur me situatën e gjyqtarit në skema delegimi e transferim në mënyrë të përmbledhur rezulton se kandidati: për periudhën 01.01.2018 - 10.12.2018, për periudhën 11.05.2021-31.12.2021 (pra 11 muaj në të parin dhe 7 muaj në të dytin), për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 (1 vit) ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile, penale dhe familjare pasi kjo gjykatë nuk rezulton të ketë ndarje në seksione.

Përfundimisht nga ana e këtij magjistrati rezultohet që të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë 5 viteve të fundit përpara kandidimit.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë edhe shkaqe të tjera penguese të parashikuara nga ligji në lidhje me kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, për të cilin nuk rezulton të ketë masa apo kriterin e “papajtueshmërisë ambientale” për të cilin nuk rezultojnë shkaqe të tilla të cilat pengojnë kandidimin e tij të mëtejshëm.

Përfundimisht nga ana e KZHK-së ju është propozuar drafti përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile,

të shpallur me vendimin nr. 18, nr.19 dhe nr. 20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.04.2023)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr.13, datë 18.01.2023, për kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:38 dhe mbaroi në orën 13:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **BIRN.**

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr.13, datë 18.01.2023, për kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i fundit për mbledhjen e sotshme që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura nga Këshilli, për kandidatit z. {...}.

Alban Toro: Edhe zoti {...} është një nga kandidatët të cilët kanë kandiduar për procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të hapura me vendimet nr. 11-20, 18.01.2023 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Natyrisht edhe për këtë kandidat kam vijuar të mbledh dhe të analizoj aktet të cilat do të provonin plotësimin e kritereve formale të tij. Ndërkohë, fillimisht më është dashur që me të kem një korrespondencë në lidhje me heqjen e çdo dyshimi në lidhje me njëanshmërinë e relatorit apo të ndonjë anëtari të Këshillit.

Në kuadër të këtij komunikimi, nga ana e tij, më datë 15.03.2023 më relatohet që: “... dua të vë në vëmendjen tuaj se në kohen kur ushtrroja detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Vlorë kam gjykuar një çështje civile ku një prej palëve ishte bashkëshortja juaj {...}, e cila e fitoi atë gjykim kundër palës tjetër {...}.”

Natyrisht, për t'i dhënë mundësinë dhe garantuar në lidhje me çdo paanshmëri apo të garantojmë procedura të tilla të cilat konfirmojnë drejtësinë në dukje apo edhe në veprim, kam vijuar korrespondencën dhe njëkohësisht kam kërkuar informacione të mëtejshme, nga të cilat ka rezultuar që nga ana e këtij kandidati ka qenë si palë kërkuese në një proces gjyqësor me zonjën {...} si dhe në vështrim të nenit 75 në këtë moment i kam kërkuar Kryetares së Këshillit të heqë dorë nga kryerja e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin {...}.

Natyrisht, pasi ka analizuar, Kryetarja me vendimin nr. 2, ka vendosur: “Mbi mospranimin e heqjes dorë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Toro nga kryerja e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} ” protokolluar me nr. 2003/1, datë 04.04.2023.

Ne evoluim e sipër të kësaj procedure nga ana e kandidatit ndërkohë procedohet me anë të komunikimit elektronik të datës 30.03.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr.2098, duke paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga kandidimi për procedurën e

lëvizjes paralele për tre pozicionet, motivin e së cilës ai e ka pasqyruar si më poshtë: “Ju njoftoj se e tërheq aplikimin tim për lëvizje paralele nga Gjykata e Durrësit për në Gjykatën e Tiranës. Arsyeja e tërheqjes është sepse së fundmi i jam nënshtruar procesit të Vettingut dhe mendoj që aplikimin ta paraqes pasi të përfundojë ky proces”.

Në kushtet kur vullneti i magistratit është parashikuar si një nga vullnetet që e ndalon këtë procedurë, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju është propozuar ky draft, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor